



Federata Aeronautike e Kosovës

RREGULLORJA PËR PËRFAQËSIMIN E REPUBLIKËS S KOSOVËS NË GARAT NDËRKOMBËTARE

Kryesia e Federatës Aeronautike të Kosovës në mbledhjen e vet të mbajtur më 04.03.2015, aprovoi:

RREGULLOREN 03/2015

PËRFAQËSIMI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË GARAT NDËRKOMBËTARE

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret për përpilimin e listës së pilotëve të cilët përfaqësojnë Republikën e Kosovës në garat ndërkombëtare.

Neni 2.

Lista e përfaqësueses së Republikës së Kosovës përcaktohet në menyrë specifike për çdo garë, në të cilën ka vendosur komisioni për paraglajdzëm që përfaqësuesja e Kosovës në paraglajdzëm të merr pjesë.

Neni 3.

Përfaqësuesja e Republikës së Kosovës në çdo garë ndërkombëtare duhet të udhëhiqet nga lideri i ekipit të përfaqësueses. Para çdo pjesëmarrje në ndonjë garë ndërkombëtare, komisioni për paraglajdzëm në kuadër të FAK propozon liderin e ekipit të Republikës së Kosovës dhe të njëjtin e dërgon për votim në kryesinë e FAK, derisa të përcaktohet lideri i ekipit.

Neni 4.

Lideri i ekipit të përfaqësueses së Republikës së Kosovës, përpilon listën e pilotëve pjesëmarrëse në përfaqësuese, gjithnjë duke u bazuar në rregulloren për hartimin e ranglistës (Regulloraja 02/2015) si dhe duke u bazuar në disiplinën (cak/distancë) në të cilë do të merr pjesë përfaqësueja.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 5.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njëjtë sikur me rastin e miratimit të saj, pra ndryshimet propozohen nga komisioni për paragllajdzëm në kuadër të FAK si dhe dëgohen për votim në kryesinë e FAK.

Neni 6.

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë, 04.03.2015

Kryetari i FAK
Fadil Gërguri

Kryetari i komisionit për paragllajdzëm
Ardall Celina